

**Përmirësimet vjetore të SNRF
Cikli 2010–2012**

IFRS 2 PAGESA TE BAZUARA NE AKSIONE

Paragrafët 15 dhe 19 janë ndryshuar dhe paragrafi 63B është shtuar. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Transaksionet në të cilat merren shërbimet

...

15 Nëse instrumentet e dhënë të kapitalit nuk kushtëzohen derisa pala tjetër të përfundojë një pjesë të caktuar të shërbimit, njësia ekonomike duhet të supozojë se shërbimet për t'u kryer nga pala tjetër, si shumë për këto instrumente të kapitalit neto, do të merren në të ardhmen gjatë *periudhës së kushtëzimit*. Njësia ekonomike do t'i trajtojë këto shërbime të kryera nga pala tjetër, gjatë periudhës së kushtëzimit, me një rritje korresponduese në kapitalin neto. Për shembull:

(a) ...

(b) nëse një punonjësi i jepen opsione në aksion, në mënyrë që të arrijë një nivel të caktuar të *kushteve të performancës* dhe të qëndrojë në njësinë ekonomike derisa ky nivel i caktuar i performancës të plotësohet, dhe zgjatja e periudhës së kushtëzimit ndryshon në varësi të kohës kur plotësohet niveli i caktuar i performancës, njësia ekonomike duhet të supozojë se shërbimet që do të kryhen nga punonjësi si shpërblim për opsionet në aksion, do të merren në të ardhmen përgjatë periudhës së pritshme të kushtëzimit. ...

Trajtimi i kushteve të përfitimit

19 Një dhënie e instrumenteve të kapitalit neto mund të kushtëzohet me plotësimin e ~~kushtëzimit~~ *kushteve të përfitimit*. Për shembull, një dhënie e aksioneve ose opsioneve në aksion për një punonjës, zakonisht kushtëzohet nga qëndrimi i punonjësit në njësinë ekonomike për një periudhë të caktuar kohe. Mund të ketë kushte të performancës, që duhet të plotësohen, të tilla si arritja nga ana e njësisë ekonomike e një rritje të caktuar në fitim ose një rritje e specifikuar në çmimin e aksionit të njësisë ekonomike. Kushtet e përfitimit, përveç kushteve të tregut, nuk duhet të merren në konsideratë kur vlerësohet vlera e drejtë e aksioneve ose opsioneve në aksion në datën e matjes. Në të vërtetë, kushtet e përfitimit do të merren parasysh duke rregulluar numrin e instrumentave të kapitalit neto të përfshirë në matjen e shumës së transaksionit, kështu që si përfundim shuma e njohur për mallrat ose shërbimet e përfituara, si shumë e instrumenteve të dhënë të kapitalit neto do të bazohet në numrin e instrumentave të kapitalit neto që kushtëzohen përfundimisht. Kështu., mbi një bazë të akumuluar, nuk njihet asnjë shumë për mallrat ose shërbimet e përfituara, nëse instrumentet e dhënë të kapitalit neto nuk mbulojnë për shkak të mosplotësimit të një ~~kondite kushteyese condition~~ *kusht të përfitimit* p.sh. pala tjetër nuk arrin të plotësojë një periudhë të caktuar shërbimi ose kushti i performancës nuk është plotësuar, subjekt i kërkesave të paragrafit 21.

...

Data efektive

...

63B *Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2010-2012, të publikuara në Dhjetor 2013, paragrafët 15 dhe 19 janë ndryshuar. Në shtojcën A përkufizimi i "kushtet e përfitimit" dhe i "kushteve të tregut" janë ndryshuar dhe janë shtuar përkufizimi i "kushteve të performancës" dhe "kushteve të shërbimit". Një njësi ekonomike duhet të aplikojë në mënyrë retrospektive këto ndryshime të transaksioneve të pagesës të bazuar në aksione për të cilat data e grantit është më 1 Korrik 2014 ose më pas. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimin për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.*

Në shtojcën A përkufizimi i "kushteve të tregut" dhe i "kushteve të përfitimit" janë ndryshuar dhe janë shtuar përkufizimi i "kushteve të performancës" dhe "kushteve të shërbimit". Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Shtojca A Kushtet e përcaktuara

Kjo shtojcë është pjesë integrale e SNRF-së.

...

kusht tregu

Një **kusht i performancës** kushtëzim mbi të cilin çmimi i periudhës, plotësimi i kushtëzimeve ose të ushtruarit e të drejtës së një instrumenti të kapitalit varet nga të qenit i lidhur me çmimin (ose vlerën) e tregut të **instrumenteve të kapitalit** të njësisë ekonomike (ose të instrumenteve të kapitalit të një tjetër njësie ekonomike të grupit), si psh:

- (a) arritja e një çmimi të specifikuar të aksionit ose e një shumë të specifikuar të **vlerës së perceptuar** të një **opsioni aksioni**; ose
- (b) arritjen e një objektivi specifik që është i bazuar në çmimin (ose vlerën) e tregut të **instrumenteve të kapitalit** të njësisë ekonomike (ose të instrumenteve të kapitalit të një njësie tjetër ekonomike të të njëjtit grup) i lidhur me një indeks të çmimeve të tregut të **instrumenteve të kapitalit** të një njësie tjetër ekonomike.

Një kusht i tregut kërkon që pala tjetër të plotësojë një periudhë e shërbimi të specifikuar (si psh., një **kusht shërbimi**): kërkesa e shërbimit mund të jetë e drejtpërdrejtë ose e nënkuptuar.

...

kushti i performancës

Një **konditë e kushtëzimit** që kërkon që:

- (a) pala tjetër të plotësojë një periudhë e shërbimi të specifikuar (d.m.th., një **kusht shërbimi**): kërkesa e shërbimit mund të jetë e drejtpërdrejtë ose e nënkuptuar. dhe
- (b) të arrihet objektivi (objektivat) e performancës ndërkohë që pala tjetër është duke ofruar shërbimin e kërkuar në (a).

Periudha e arritjes së objektivit (objektivave) të performancës:

- (a) nuk duhet të kalojë përtej periudhës së shërimit: dhe
- (b) mund të fillojë përpara periudhës së shërbimit me kusht që data e fillimit të objektivit të performancës të mos jetë në thelb përpara fillimit të periudhës së shërbimit.

Një objektivi performancë përcaktohet duke iu referuar:

- (a) operacioneve (ose aktiviteteve) të veta të njësisë ekonomike ose operacioneve (ose aktiviteteve) të një njësie ekonomike tjetër të së njëjtit grup (d.m.th., jo kusht tregu): ose
- (b) çmimi (ose vlera) e instrumenteve të kapitalit të një njësie ekonomike ose instrumentet e kapitalit të një njësie tjetër ekonomike të të njëjtit grup (duke përfshirë aksionet dhe opsionet e aksionit) (d.m.th., një kusht tregu).

Një objektivi i performancës mund të lidhet ose me performancën e njësisë ekonomike mnë tërësi ose me një pjesë të njësisë ekonomike (ose pjesë të grupit), si psh., një divizion apo një i punësuar individ.

...

konditat e shërbimit

Një konditë e kushtëzimit që kërkon nga pala tjetër të plotësojë një periudhë e shërbimi të specifikuar gjatë së cilës ajo i ofron shërbime njësisë ekonomike. Nëse pala tjetër, pavarësisht nga shkaqet, nuk mund të ofrojë shërbimin gjatë **periudhës së kushtëzuar**, ajo ka dështuar për të plotësuar kushtin e vendosur. Një konditë shërbimi nuk kërkon të arrihet ndonjë objektiv performance.

...

kushtet e përfitimit

Një kusht që përcakton nëse njësia ekonomike ka marrë shërbimin i cili i jep të drejtë palës tjetër për të marrë mjete monetare, aktive të tjera ose **instrumente të kapitalit neto** të njësisë ekonomike, sipas një **marrëveshje të pagesës të bazuar në aksion**. Një konditë e kushtëzimit janë është ose një **konditë shërbimi** ose një **kusht performance**. Kushtet e shërbimit kërkojnë që pala tjetër të plotësojë një periudhë të caktuar të shërbimit. Kushtet e performancës kërkojnë që pala tjetër të plotësojë një periudhë të caktuar të shërbimit dhe objektiva të caktuara lidhur me performancën (të tilla si një rritje e caktuar në fitimin e njësisë ekonomike gjatë një periudhe të caktuar kohe). Një kusht performance mund të përfshijë një **kusht tregu**.

Ndryshime të SNRF 3 Kombinime biznesi

Paragrafët 40 dhe 58 janë ndryshuar dhe janë shtuar paragrafët 64I dhe 67A dhe titujt përkatës të tyre. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Shuma të kushtëzuara

...

- 40 Blerësi do të klasifikojnë një detyrim për të paguar një shumë të kushtëzuar që plotëson përkufizimin e një instrumenti financiar si një detyrim financiar ose si kapital në bazë të përcaktimeve të një instrumenti kapitali dhe një detyrim financiar në paragrafin 11 të SNK 32 Instrumentet Financiarë: Paraqitja, ~~apo SNRF të tjera të aplikueshme~~. Blerësi do të klasifikojë si një aktiv të drejtën për kthimin e shumës transferuar parë nëse kushtet e specifikuara janë plotësuar. Paragrafi 58 jep udhëzime mbi kontabilizimin e mëvonshëm të shumës së kushtëzuar.

...

Shuma të kushtëzuara

- 58 Disa ndryshime në vlerën e drejtë të shumës së kushtëzuar që blerësi njuh pas datës së blerjes mund të jenë rezultat i informacionit shtesë që blerësi ka siguruar pas asaj date në lidhje me fakte dhe rrethana që kanë ekzistuar në datën e blerjes. Ndryshime të tilla janë rregullime të periudhës së matjes në përputhje me paragrafët 45-49. Gjithsesi, ndryshime që rezultojnë nga ngjarje pas datës së blerjes, si arritja e një pikësynimi në lidhje me fitimin, arritja e një çmimi të specifikuar për aksionet ose arritja e një përfundimi në një projekt kërkimi dhe zhvillimi, nuk janë rregullime të periudhës së matjes. Blerësi duhet të marrë në konsideratë ndryshimet në vlerën e drejtë të shumave të kushtëzuara të cilat nuk janë rregullime të periudhës së matjes si më poshtë:

(a) ...

(b) Të tjera shuma të kushtëzuara e klasifikuar si një aktiv ose detyrim që:

- (i) është një instrument financiar dhe është brenda objektit të SNRF 9 duhet të matet me vlerën e drejtë në çdo datë raportuese, me çdo fitim apo humbje rezultuese në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve ose në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe ndryshimet në vlerën e drejtë duhet të njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9.
- (ii) nuk përfshihet brenda objektit të SNRF 9 dhe duhet të kontabilizohet në përputhje me SNK 37 ose me ndonjë SNRF tjetër si të jetë më e përshtatshme, matet me vlerën e drejtë në çdo datë raportuese dhe ndryshimet në vlerën e drejtë duhet të njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

...

Data efektive

...

- 64I Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2010-2012, të publikuara në Dhjetor 2013, paragrafët 40 dhe 58 janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 64A dhe titulli përkatës. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë në mënyrë retrospektive këto ndryshime të kombinimit të bizneseve për të cilat data e blerjes është më 1 Korrik 2014 ose më pas. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Një njësi ekonomike mund të aplikojë më herët këtë ndryshim me kusht që të aplikohen dhe SNRF 9 dhe SNK 37 (të dy këto të ndryshuar nga Përmirësimet Vjetore të SNRF-ve Cikli 2010-2012). Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime më herët ajo duhet ta sqarojë këtë fakt në shënimet shpjeguese.

...

Referenca në SNRF 9

67A Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard, por ende nuk zbaton SNRF 9, çdo referencë për SNRF 9 do të lexohet si një referencë për SNK 39.

Ndryshime të mëpasshme të SNRF-ve të tjera si pasojë e ndryshimeve të SNRF 3

Ndryshime të SNRF 9 *Instrumentet Financiare* (publikuar në Nentor 2009)

Paragrafi 4 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 8.1.4. Teksti i ri është i nënvizuar.

Investimet në instrumente kapitali

- 5.4.4 Në njohjen fillestare, një njësi ekonomike mund të bëjë një zgjedhje të pa pakthyeshme për të pasqyruar në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ndryshimet e mëpasshme në vlerën e drejtë të një investimi në një instrument kapitali brenda objektit të kësaj SNRF që nuk është mbajtur për tu shitur dhe gjithashtu nuk është shumë e kushtëzuar e një blerësi në një kombinim biznesi për të cilin aplikohet SNRF 3 *Kombinimi i bizneseve*.

...

8.1 Data e hyrjes në fuqi

...

- 8.1.4 Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2010-2012, të publikuara në Dhjetor 2013, paragrafi 5.4.4 është ndryshuar si një ndryshim i mëpasshëm që rrjedh nga ndryshimet e SNRF 3. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë në mënyrë retrospektive këtë ndryshim tek kombinimet e bizneseve për të cilat aplikohet SNRF 3.

Ndryshime të NRF 9 *Instrumentet Financiare* (publikuar në tetor 2010)

Paragrafët 4,2,1 dhe 5,7,5 janë ndryshuar dhe paragrafi 7,1,4 është shtuar. Teksti i ri është i nënvizuar.

4.2 Klasifikimi i pasiveve financiare

- 4.2.1 Një njësi ekonomike duhet të klasifikojë të gjitha pasivet financiare si të matura më pas me koston e amortizuar duke përdorur *metodën e interesit efektiv*, me përjashtim të:

(a) ...

- (e) shumës së kushtëzuar të një blerësi në një kombinim biznesi për të cilin aplikohet SNRF 3 *Kombinimi i bizneseve*. Një shume e tillë e kushtëzuar duhet që më pas të matet me vlerën e drejtë.

...

Investimet në instrumente kapitali

- 5.7.5 Në njohjen fillestare, një njësi ekonomike mund të bëjë një zgjedhje të pakthyeshme për të paraqitur në të ardhura të tjera të gjithëpërfshirëse ndryshimet e mëpasshme në vlerën e drejtë të një investimi

në një instrument kapitali brenda objektit të këtij SNRF-je, që nuk është i mbajtur për tregtim dhe nuk është shumë e kushtëzuar e një blerësi në një kombinim biznesi për të cilin aplikohet SNRF 3.

...

7.1 Data e hyrjes në fuqi

...

7.1.4 Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2010-2012, të publikuara në Dhjetor 2013, paragrafët 4.2.1 dhe 5.7.5 janë ndryshuar si një ndryshim i mëpasshëm që rrjedh nga ndryshimet e SNRF 3. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë në mënyrë retrospektive këtë ndryshim tek kombinimet e bizneseve për të cilat aplikohet SNRF 3.

Ndryshime të SNK 37 Provizionet, Pasivet dhe Aktivet e Kushtëzuara

Paragrafi 5 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 99. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Qëllimi

...

5 Kur një Standard tjetër trajton një lloj provizioni specifik, pasiv të kushtëzuar ose aktiv të kushtëzuar, një njësi ekonomike do të zbatojë atë Standard në vend të këtij Standardi. Në mënyrë të ngjashme, disa lloje provizionesh janë trajtuar gjithashtu në Standardet:

(a) ...

(d) përfitimet e punonjësve (shiko SNK 19 *Përfitimet e punonjësve*); ~~dhe~~

(e) kontratat e sigurimit (shih SNRF 4 *Kontratat e sigurimit*). Megjithatë ky Standard zbatohet për provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara të një siguruesi, që janë të ndryshme nga ato që rrjedhin nga detyrimet e tij kontraktuale dhe të drejtat sipas kontratës së sigurimit brenda objektit të SNRF 4. dhe

(f) shuma e kushtëzuar e një blerësi në një kombinim biznesi (shih SNRF 3 *Kombinimi i bizneseve*).

...

Data efektive

...

99 Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2010-2012, të publikuara në Dhjetor 2013, paragrafi 5 është ndryshuar si një ndryshim i mëpasshëm që rrjedh nga ndryshimet e SNRF 3. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë në mënyrë retrospektive këtë ndryshim tek kombinimet e bizneseve për të cilat aplikohet SNRF 3.

Ndryshime të SNK 39 *Instrumentet financiare: Njohja dhe matja*¹

Paragrafi 9 është shtuar dhe është shtuar paragrafi 108F. Teksti i ri është i nënvizuar.

Përkufizimet

...

9 Përkufizimet e termave të mëposhtme janë dhënë në këtë standard sipas këtyre kuptimeve specifike:

Përkufizimet e katër kategorive të instrumenteve financiare

Një aktiv financiar ose një detyrim financiar i matur me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit dhe humbjes është një aktiv financiar ose një detyrim financiar që plotëson çdo kushtëzim të mëposhtëm:

(a) ...

(aa) Është shumë e kushtëzuar e një blerësi në një kombinim biznesi për të cilin aplikohet SNRF 3 *Kombinimi i bizneseve*.

(b) ...

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

...

108F Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2010-2012, të publikuara në Dhjetor 2013, paragrafi 9 është ndryshuar si një ndryshim i mëpasshëm që rrjedh nga ndryshimet e SNRF 3. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë në mënyrë retrospektive këtë ndryshim tek kombinimet e bizneseve për të cilat aplikohet SNRF 3.

1 SNRF 9 *Instrumentet Financiare* (publikuar në Tetor 2010) dhe SNRF 9 *Instrumentet Financiare (Kontabiliteti mbrojtës dhe ndryshime të SNRF 9, SNRF 7, dhe të SNK 39)* (publikuar në Nëntor 2013) ka fshirë "përkufizimin e katër kategorive të instrumenteve financiare" në paragrafin 9 të SNK 39.

Ndryshime të SNRF 8 Segmentet e shfrytëzimit

Paragrafët 22 dhe 28 janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 36C. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Informacion i përgjithshëm

- 22 Një njësi ekonomike duhet të japë informacionin e përgjithshëm të mëposhtëm:
- (a) faktorët e përdorur për identifikimin e segmenteve raportues të njësisë ekonomike, përfshirë bazën e organizimit (për shembull, nëse drejtimi ka zgjedhur të organizojë njësinë ekonomike sipas produkteve dhe shërbimeve të ndryshme, zonave gjeografike, kushteve rregullatore, ose sipas një kombinimi të faktorëve të ndryshëm, dhe nëse segmentet janë bashkuar): ~~dhe~~
 - (aa) gjykimet e bëra nga drejtimi në aplikimin e kritereve të bashkimit në paragrafin 12, Kjo përfshin një përshkrim të shkurtër të segmenteve të shfrytëzimit që janë bashkuar në këtë mënyrë dhe indikatorët ekonomik që janë vlerësuar në vendimin e marrë që bashkimi i segmenteve të shfrytëzimit ndajnë karakteristika të njëjta ekonomike: dhe
 - (b) llojet e produkteve e shërbimeve nga të cilët çdo segment raportues krijon të ardhurat e tij.
- ...

Rakordimet

- 28 Një njësi ekonomike duhet të bëjë rakordimet e të gjithë zërave të mëposhtëm:
- (a) ...
 - (c) totali i aktiveve të segmenteve raportuese në aktivet e njësisë ekonomike në qoftë se aktivet e segmentit janë raportuar në përputhje me paragrafin 23.
 - (d) ...

Periudha kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

- ...
- 36C Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2010-2012, të publikuara në Dhjetor 2013, paragrafët 22 dhe 28 janë ndryshuar. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këto amendamente për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Korrik 2014 ose më pas. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2014, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Ndryshime në SNK 16 Aktivet Afatgjata Materiale (toka, ndërtesa, makinerie pajisje)

Paragrafi 35 është ndryshuar dhe janë shtuar paragrafët 80A dhe 81H. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Modeli i rivlerësimit

- ...
- 35 Kur një zë i klasës Toka, ndërtesa, makineri e pajisje rivlerësohet, i gjithë amortizimi i akumuluar vlera neto kontabël e atij aktivi rregullohet sipas vlerës së rivlerësuar. Në datën e rivlerësimit, aktivi trajtohet sipas një nga mënyrave të mëposhtme:
- (a) i ri paraqitur në mënyrë proporcionale vlera bruto e mbartur rregullohet në një mënyrë që është në përputhje me ndryshimin në vlerën e bartur bruto të aktivit në mënyrë që rivlerësimin e vlerës së mbartur të aktivit. Për shëmbull vlera e mbartur bruto mund të rivlerësohet duke iu referuar të dhënave të vëzhguara të tregut ose mund të rivlerësohet në mënyrë proporcionale me ndryshimin e vlerës neto kontabël. Amortizimi i akumuluar në ditën e rivlerësimit rregullohet për të balancuar diferencën midis vlerës së mbartur bruto dhe vlerës neto kontabël të aktivit pas marrjes në konsideratë të humbjet e akumuluar nga çvlerësimi. ose pas rivlerësimit arrin vlerën e tij të rivlerësuar. Kjo metodë shpesh përdoret kur një aktiv rivlerësohet nëpërmjet përdorimit të një treguesi për të përcaktuar kosto e tij të amortizuar të zëvendësimit. (shih SNK 13)
 - (b) amortizimi i akumuluar eliminohet tek vlera e mbartur bruto e aktivit. dhe vlera neto riparaqitet me shumën e rivlerësuar të aktivit. Kjo metodë përdoret shpesh për ndërtesat.
- Shuma e rregullimit që vjen nga riparaqitja ose eliminimi i amortizimit të akumuluar formon pjesë të rritjes ose pakësimit të vlerës kontabël (neto) e cila trajtohet në përputhje me paragrafët 39 dhe 40.

Dispozitat kalimtare

- ...
- 80A Paragrafi 35 është ndryshuar nga *Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2010-2012*. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këtë ndryshim për të gjitha rivlerësimet të njohura në periudhat raportuese që fillojnë më datën e aplikimit fillestar të këtij ndryshimi ose më vonë, dhe për periudhën vjetore pararendëse. Një njësi ekonomike gjithashtu mund të paraqesë informacionin krahasues të rregulluar për çdo periudhë më të hershme, por kjo nuk kërkohet. Në qoftë se një njësi ekonomike prezanton informacion krahasues të pa rregulluar për ndonjë periudhë më të hershme, ajo duhet të identifikojë qartazi që informacioni nuk është i rregulluar, të deklarojë që informacioni është përgatitur mbi baza të ndryshme, dhe t'i shpjegojë këto baza.

Data efektive

- ...
- 81H *Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2010-2012*, të publikuara ne Dhjetor 2013, paragrafi 35 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 80A. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këtë amendament për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Korrik 2014. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimin për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Ndryshime të SNK 24 Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura

Paragrafi 9 është ndryshuar dhe janë shtuar paragrafët 17A, 18A, dhe 28C. Teksti i ri është i nënvizuar.

Përkufizimet

- 9 Përkufizimet e termave të mëposhtme janë dhënë në këtë standard sipas këtyre kuptimeve specifike:
- Një *palë e lidhur* është një person apo njësi ekonomike që është e lidhur me njësinë ekonomike e cila është duke përgatitur pasqyrat e saj financiare (në këtë standard është referuar si 'njësia ekonomike raportuese').
- (a) ...
- (b) Një njësi ekonomike është e lidhur me një njësi ekonomike raportuese nëse zbatohet ndonjë prej kushteve të mëposhtme:
- (i) ...
- (viii) Njësia ekonomike, ose cdo anëtar i grupit ku bën pjesë, ofron personel drejtues kryesor për njësinë raportuese ose për shoqërinë mëmë të njësisë raportuese.
- ...

Të gjitha njësitë ekonomike

17A Nëse një njësi ekonomike merr shërbime për personel drejtues kryesor nga një njësi ekonomike tjetër ("njësi ekonomike drejtuese"), njësisë ekonomike nuk i kërkohet të aplikojë kërkesat e paragrafit 17 për kompensimet e paguara ose për tu paguar nga njësia ekonomike drejtuese për personelin e saj drejtues apo për drejtorët e saj.

18 ...

18A Shumat që njësia ekonomike duhet të paguajë për shërbimin e personelit drejtues kryesor që janë ofruar nga një njësi ekonomike drejtuese e veçantë duhet të shtjellohen në informacionin shpjegues.

...

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

28C Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2010-2012, të publikuara në Dhjetor 2013, paragrafi 9 ka ndryshuar dhe janë shtuar paragrafët 17A dhe 18A. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këtë amendament për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Korrik 2014. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimin për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Ndryshime të SNK 38 *Aktivitet afat gjate jo materiale*

Paragrafi 80 është ndryshuar dhe janë shtuar paragrafët 130H dhe 130I. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Modeli i rivlerësimit

- ...
- 80 Nëse Kur një aktiv jo material rivlerësohet, i gjithë amortizimi i akumuluar vlera neto kontabël e atij aktivi rregullohet sipas vlerës së rivlerësuar. Në datën e rivlerësimit, aktivi trajtohet sipas një nga mënyrave të mëposhtme:
- (a) i ri paraqitur në mënyrë proporcionale vlera bruto e mbartur rregullohet në një mënyrë që është në përputhje me ndryshimin në vlerën e mbartur bruto të aktivit në mënyrë që rivlerësimin e vlerës së mbartur të aktivit. Për shembull vlera e mbartur bruto mund të rivlerësohet duke iu referuar të dhënave të vëzhguara të tregut ose mund të rivlerësohet në mënyrë proporcionale me ndryshimin e vlerës neto kontabël. Amortizimi i akumuluar në ditën e rivlerësimit rregullohet për të balancuar diferencën midis vlerës së mbartur bruto dhe vlerës neto kontabël të aktivit pas marrjes në konsideratë të humbjet e akumuluar nga çvlerësimi pasi rivlerësimi barazohet me vlerën e rivlerësuar, ose
 - (b) amortizimi i akumuluar eliminohet tek vlera e mbartur bruto e aktivit, dhe vlera neto riparaqitet me shumën e rivlerësuar të aktivit.
- Shuma e rregullimit të amortizimit të akumuluar formon pjesë të rritjes ose pakësimit të vlerës kontabël (neto) e cila trajtohet në përputhje me paragrafët 85 dhe 86.
- ...

Dispozita kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

- ...
- 130H Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2010-2012, të publikuara në Dhjetor 2013, paragrafët 80 është ndryshuar. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këtë amendament për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Korrik 2014. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimin për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- 130I Një njësi ekonomike duhet të aplikojë ndryshim e bërë nga Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2010-2012 për të gjitha rivlerësimet të njohura në periudhat raportuese që fillojnë më datën e aplikimit fillestar të këtij ndryshimi ose më vonë, dhe për periudhën vjetore pararendëse. Një njësi ekonomike gjithashtu mund të paraqesë informacionin krahasues të rregulluar për çdo periudhë më të hershme, por kjo nuk kërkohet. Në qoftë se një njësi ekonomike prezanton informacion krahasues të pa rregulluar për ndonjë periudhë më të hershme, ajo duhet të identifikojë qartazi që informacioni nuk është i rregulluar, të deklarojë që informacioni është përgatitur mbi baza të ndryshme, dhe t'i shpjegojë këto baza.

